

ADMINISTRATA &
QYTETARËTKULTURA &
EVENTET

TURIZËM

SPORT

EKONOMI &
BIZNESMEDIJA DHE
KOMUNIKIMINjësitë
Administrative

INDUSTRI DHE TREGETISIA | POLITIKA E PRIVATISISE

EN | AL



Deklaratë e Bashkisë së Tiranës

Kreu → Administrata & Qytetarët → Aktivitete dhe Publikime → Lajme → Deklaratë e Bashkisë së Tiranës

**Erion Veliaj -
Youtube**

SHPËRNDAJE



Në mbështetje të ligjit nr. 37/2018 dhe vendimit nr. 352, datë 04.04.2019 të Këshillit të Ministrave, pranë Bashkisë së Tiranës u ngrit komisioni për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”,

ADMINISTRATA &
QYTETARËTKULTURA &
EVENTET

TURIZËM

SPORT

EKONOMI &
BIZNES

MEZERI MTESE

Njësitë
Administrative

Twitter

**Bashkia Tiranë**
@BashkiaTirane

Mbill lulen tënde! 🌸🌹🌻

Tirana gjelbëron! 🌞🌳 Super yjet e
vegjël mbollën lule ngjyra-ngjyra për
t'i shtuar më shumë gjallëri qytetit.

Jeni më të mirët kalamaja! 🙌

19/05/2021 08:38[Reply](#) [Retweet](#) [Favorite](#)

Komisioni i vleresimit dhe negocimit nisi punën me hartimin e thirrjes së hapur për palët private të interesuara, për të marrë pjesë në këtë procedurë konkurruese dhe paraqitjen e një oferte financiare për ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar dhe zhvillimin e zonës urbane. Thirrja e hapur u publikua në faqen zyrtare të Bashkisë së Tiranës, si dhe u dërgua për botim në buletin zyrtar të Agjencisë së Prokurimeve Publike.

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave, komisioni i vlerësimit, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nën ekspertizën konsulentit të përzgjedhur për të ndihmuar komisionin, nisi punën me negocimin e ofertës së palës private të interesuar.

Komisioni i negocimit, në mbështetje të të gjitha kërkesave të komunitetit të artistëve për një teatër modern, i cili përmbush kriteret e nevojshme për realizimin profesional e me cilësi të shfaqjeve teatrale, nuk arriti të gjejë dakordësinë me palën private. Modeli financiar i propozuar nga pala private e interesuar për ndërtimin e godinës së Teatrit të ri Kombëtar dhe zhvillimit të zonës urbane, por edhe kompleksiteti i projektit, i cili duhet të përmbushte të gjitha kërkesat teknike të kërkuara nga përfaqësia e artistëve në komision, nuk

Nisur nga interesi për të ndërtuar një godinë bashkëkohore dhe moderne, që plotëson të gjitha kushtet teknike për realizimin e shfaqjeve, e cila t'i shërbejë komunitetit artistik teatror dhe publikut artdashës, Qeveria dhe Bashkia e Tiranës vendosën që godina e re e Teatrit Kombëtar të ndërtohet nga shteti si një investim publik.

Për këto arsye, Bashkia e Tiranës do t'i kërkojë Qeverisë Shqiptare që ta mbështesë financiarisht për realizimin e kësaj vepre ikonike për qytetin dhe vendin tonë. Bashkia e Tiranës zotohet se do ta ndërtojë Teatrin e ri Kombëtar në një kohë më të shkurtër kalendarike dhe në përmbushje të të gjitha kërkesave teknike të shprehura nga komuniteti i artistëve në konsultimet publike.

Puna për ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar do të nisë brenda vitit të 100 vjetorit të shpalljes së Tiranës Kryeqytet të Shqipërisë.

SHPËRNDAJE

Pyetje

ADMINISTRATA &
QYTETARËT

KULTURA &
EVENTET

TURIZËM

SPORT

EKONOMI &
BIZNES

WEDDRI MTEE

Njësitë
Administrative

0800 0888

info@tirana.al

Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001,
Tiranë, Shqipëri

Bashkia e Tiranës

Politikat e privatësisë

Kontakttoni